Udhëzim – Kyçje në sistemin nga ana e prindit dhe pasqyra e raportit javor

## 1. Kyçje në sistemin për shfrytëzuesit e ri (prindërit/ kujdestarët)

Që të mund prindi / kujdestari të ketë qasje në sistemin Ditari-E, është e nevojshme që udhëheqësi i klasës i fëmijës së tij / saj t'i fusë të dhënat e tij / saj përkatëse në sistemin. Pasi që udhëheqësi i klasës do të fusë emrin dhe mbiemrin dhe adresën e saktë të e-mail-it në fushat e duhura, sistemi do të dërgojë njoftim në adresën e postës elektronike të futur për prindin me informata për emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin që prindi duhet të përdorë për hyrje të mëtejshme në sistem.

Hyrja e parë në sistem me informacionin e gjeneruar të përdoruesit Pasi që prindi / kujdestari do të marrë të dhënat e përdoruesit në adresën e tij të postës elektronike, mund të hyjë për herë të parë në Ditarin-E në formën e hyrjes në linkun e mëposhtëm: https: //ednevnik.edu.mk /.




Pas futjes së informacioneve të marra për përdoruesin, është e nevojshme prindi të bëjë verifikimin e llogarisë së përdoruesit në mënyrën e mëposhtme:

- ta fusë adresën e vet të postës elektronike në formën e verifikimit

Sistemi do të dërgojë link për verifikimin e llogarisë në adresën e postës elektronike të futur ta kontrollojë emailin e futur dhe të klikojë në linkun e marrë

- ta fusë fjalëkalimin që ai / ajo dëshiron të përdorë për të hyrë në Ditarin-E

të kyçet në Ditarin- E me adresën e postës elektronike të futur (si emër përdoruesi) dhe fjalëkalimin që e ka futur për hyrje

## 2. Pasqyrimi i raportit javor

Pasi që do të kyçeni në sistemin, në faqen fillestare i keni të dhënat personale të fëmijës suaj si dhe hyrje në raportin javor.




Pasi që do të klikoni në butonin **kontrollo raportin** do të keni mundësi për të parë raportin për javën aktuale me përmbajtjet mësimore që i mëson fëmija i juaj.



Në mënyrë shtesë, në sistemin janë ruajtur të gjitha raportet javore nga fillimi i vitit shkollor.
Me zgjedhjen e butonit të javës së kaluar keni mundësi për të parë raportet e mëparshme.